

DRITËRO AGOLLI
SHKËLQIMI DHE RËNIA E SHOKUT ZYLO
Fragment

1.

E mbarova raportin dhe e dhashë në drejtorinë N të Ministrisë sonë, nga e cila isha ngarkuar. Drejtoria N merrej me sektorin e kulturës dhe artit. Në zyrë, përveç shokut Shemshedin, që drejtonte këtë sektor, ishte edhe shoku Zylo, që drejtonte sektorin e librit. Shoku Shemshedin e mori raportin dhe ia shpuri shokut Q., i cili i kishte nën kujdestari të dy këto drejtori. Tek shoku Q. shkuan të dy drejtorët dhe unë tok me ta. Rrija në zyrë dhe dëgjoja tek flitej për raportin. Ai do të mbahej në një mbledhje të madhe, në të cilën do të kishte shumë personalitete të shquara.

— Raportin do ta mbaj unë, – tha shoku Shemshedin.

Tjetri e dëgjonte me njëfarë ironie në buzët e holla.

— Mund ta mbaj edhe unë, – tha i dyti, shoku Zylo.

“Të dy paskan besim se raporti ka dalë i mirë, mendova unë. Sikur të mos kishin besim, nuk do të praninin ta mbanin as njëri, as tjetri.”

— Pse ta mbash ti? – u hodh shoku Shemshedin. – Demkës ia dhashë unë tezat. Për ato teza punova dhjetë ditë me radhë. Këtë e di edhe shoku Q.

Unë u vrenjta në fytyrë. Shoku Shemshedin nuk më kishte dhënë asnjë teze...

— Raportin do ta mbaj unë. Për këtë bisedova me shokun Q. Shoku Q. ishte dakord, – tha shoku Zylo shkurt dhe kategorikisht.

Shoku Shemshedin u ngrit nga tavolina.

— Çuditë, Zylo: ta bëj unë raportin dhe ta mbash ti! Kërkon të shkëlqesh në mbledhje. Nuk të shkojnë, – tha shoku Shemshedin.

— Raportin nuk e bëre vetëm ti, por ndihmuam të gjithë. Unë ndihmova, ky ndihmoi... – dhe shoku Zylo tregoi me dorë nga unë.

“E çuditshme! Unë paskam ndihmuar! A nuk e shkrova nga e para me këto duar?” - mendova.

— Raportin do ta mbajë Zyloja. Ai e ka zërin më të mirë se tëndin. Lexon më bukur, më qetë. Ti impresionohesh... – tha shoku Q.

— Po unë u lodha me... – tha shoku Shemshedin.

— Për punën të falenderojmë. Edhe ti edhe Demka ndihmuat që raporti të përpilohej mirë dhe saktë. Ato që ju thashë unë i keni vënë të gjitha... Fundja për një raport punojnë disa shokë, por njëri e mban, - tha shoku Q.

2.

Fjala iu dha shokut Zylo. Unë dëgjoja frazat e mia. Zyloja lexonte me një ton të qetë, qartë dhe bukur. Të gjithë dëgjonin dhe e ndiqnin me interes. Gruaja e shokut Zylo herë pas here afronte gojën te veshi im e thoshte:

— Dy javë të tëra u sfillit Zyloja me këtë raport. Gjer më dymbëdhjetë të natës ka punuar. Por nuk më vjen keq, sepse e ka bërë të mirë.

Unë ulja kokën e heshtja. Ndonjëherë më vinte për të qeshur me fjalët e saj.

— Ke për të parë, të gjithë do ta pëlqejnë. Zyloja, po iu vu një pune, ia del mbanë, tha ajo.

— Ia del, - thashë.

— Ka ca njerëz që e kanë inat. Ke parë ti? Më tha se donte t'ia përlante raportin shoku Shemshedin. Zyloja e bëri, shoku Shemshedin donte ta mbante për t'u mburrur. Kur e mori

vesh shoku Q., i dha një dush shokut Shemshedin, që do ta mbajë mend për tërë jetën! Ke parë ti!...

Mua më hipi në kokë një marrëzi. Më lindi dëshira ta fyeja këtë budallaqe. Por u përmbajta.

— Sa i ka pëlqyer shokut Q. raporti i Zylos! Shiko si buzëqesh shoku Q. — tha Adila duke bërë me kokë nga presidiumi. — Ama i tha Zylos që kur ia lexoi raportin: “Kam ndjerë kënaqësi duke e lexuar. Bravo! Do të na nderosh!”

— Ashtu është, - thashë unë dhe u përpoqa ta hedh mendjen diku jashtë sallës për të mos e dëgjuar këtë llafazane. Por ajo nuk pushonte.

— E ke lexuar ti raportin e Zylos apo e dëgjon për herë të parë? — pyeti Adila.

Unë e humba durimin.

— E kam lexuar përpara se shoku Zylo, - thashë.

Ajo shtangu njëherë. Pastaj ia dha të qeshurit.

— Qenke shakaxhi, Demkë!

— Jam pak shakaxhi, - thashë unë.